

RAPORT TRE MUJOR I MONITORIMIT  
**Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale**  
*Dhjetor 2012, Prizren*

## PËRMBAJTJE

<b>I. Përmbledhje Ekzekutive .....</b>	<b>2</b>
<i>Konstatime të përgjithshme mbi transparencën lokale .....</i>	<b>2</b>
<i>Të gjeturat e monitorimit tre mujor .....</i>	<b>3</b>
<b>II. Për projektin .....</b>	<b>5</b>
<b>III. Pse monitorim i transparencës .....</b>	<b>6</b>
<b>IV. Ligji dhe komuna .....</b>	<b>7</b>
<b>V. Aktivitetet/Raportimi.....</b>	<b>7</b>
<b>VI. Të gjeturat specifike të monitorimit.....</b>	<b>8</b>
<b>VII. Rekomandime.....</b>	<b>10</b>
<b>VIII. Ndikimi i projektit .....</b>	<b>12</b>
<b>IX. Falënderim.....</b>	<b>13</b>
<b>EC Ma Ndryshe.....</b>	<b>14</b>

*Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Transparenca online e komunës së Prizrenit”, i përkrahur financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë*



British Embassy  
Prishtina

## I. Përmbledhje ekzekutive

Ky raport përmbledh punën tre mujore (shtator, tetor dhe nëntor 2012) të monitorimit në kuadër të projektit "Transparenca online e komunës së Prizrenit". Të gjeturat e monitorimit gjatë kësaj periudhe vërtetojnë se transparenca jo e duhur në vendimmarrje ka shtyrë drejtuesit e komunës që në disa raste të marrin vendime që nuk përputhen me interesat e qytetarëve apo të banorëve të lagjeve të caktuara, që në rastet ekstreme ose nuk kanë pas bazë ligjore, kanë qenë në kundërshtim me ligjet në fuqi apo edhe vet Kushtetutën e Republikës së Kosovës. E, respektimi i ligjit paraqet parakushtin kryesor për qeverisje të mirë.

Kapitulli X i Kushtetutës respektivisht neni 124 paragrafi 6 përcakton se "komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore". Edhe neni 11 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale përcakton se "të gjitha aktet komunale duhet të jenë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës". Mirëpo, hulumtimet e bëra nga monitoruesit e EC Ma Ndryshe kanë nxjerrë në pah faktin se këto dispozita janë injoruar në disa raste nga ekzekutivi dhe legjislativi i Prizrenit, gjë që ka shtyrë edhe instancat më të larta shtetërore të kërkojnë veprime konform ligjit nga autoritetet komunale.

Mungesa e dialogut të mirëfilltë me qytetarët e komunës por edhe me institucionet tjera qendrore ka shtyrë qeverinë komunale të Prizrenit të veproj jashtë kornizave ligjore, madje duke prezantuar edhe akte pa bazë juridike pranë legjislativit lokal, i cili përkundër mandatit për mbikëqyrje të ekzekutivit nuk i ka kthyer ato për rishqyrtim, por përkundrazi i ka miratuar.

Transparenca nuk duhet të jetë një çështje e diskutueshme, sepse transparenca dhe llogaridhënia përbëjnë hapin e parë drejt qeverisjes së mirë dhe efektive. Transparenca e duhur rreth vendimmarrjes sjell dobi si për komunitetin ashtu edhe për udhëheqësit komunal. Të qenit të informuar rreth projekteve komunale ndihmon qytetarët që të identifikohen dhe të lidhen me komunitetin. Një lidhje e tillë është jetike për qeverinë lokale që të funksionojë në mënyrë efektive dhe të marrë vendime në interes të publikut. Përveç kësaj, shpërndarja e informatave përbën një parakusht të rëndësishëm, për adresimin e prioriteteve të qytetarëve dhe hartimin e buxhetit racional. Koordinimi i duhur ndërmjet trekëndëshit, qytetar, komunë dhe Qeveri mundëson identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të qytetarëve por paraqet ndihmesë edhe në evitimin e shkeljeve të dispozitave ligjore.

### *Konstatimet e përgjithshme mbi transparencën lokale*

Transparenca në komunën e Prizrenit përkundër përpjekjeve modeste të lidhshpimit komunal vazhdon të jetë në nivel të ultë, që manifestohet me informim jo-adekuat, mos përfshirje të duhur në vendimmarrje dhe aspak llogaridhënie karshi qytetarëve.

Udhëzimi Administrativ 2008/09 i MAPL-së përcakton se përveç takimeve publike komunat janë të obliguara ti informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç rregullohet edhe me statutin e komunës.

Ky udhëzim administrativ parasheh që në kuadër të Planit të veprimit për transparencë të

përfshihen edhe iniciativa si: Raportimi më i shpeshtë në media për çështjet që lidhen me përdorimin e buxhetit komunal, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës komunale, planifikimin urban, investimet, të hyrat komunale dhe çështje tjera. Pastaj mbajtjen e konferencave periodike të shtypit (çdo dy javë ose çdo muaj) por edhe organizimin e seancave pyetje-përgjigje me publikun e gjerë ose grupet e interesit. Gjithashtu kërkohet përditësimi i ueb-faqes zyrtare të komunës.

Ilustrimi më i mirë për mos funksionimin e transparencës komunale përmes ueb faqes së komunës së Prizrenit është postimi i statutit të vjetër, ku figuron se: “Emblema e Komunës është “Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit”, ndërsa në rreth do të jetë teksti “1878-Prizren”, edhe pse ka kohë që kjo dispozitë e statutit është ndryshuar, si pasojë e aktgjykimit përkatës të Gjykatës Kushtetuese.

Po ashtu statuti i komunës së Prizrenit përmban dispozita për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në mbledhje, veprimtarinë dhe mënyrën e vendosjes në punët publike, për zbatimin e të cilave mekanizma, ekzekutivi nuk ka treguar një qasje të duhur proaktive.

#### *Të gjeturat e monitorimit tre mujor*

Të gjeturat kryesore të monitorimit tre mujor tregojnë se: Mos respektimi i kritereve të ndërtimit nuk ndëshkohet nga institucionet; ekzistojnë praktika të investimeve publike në pronat e kontestuara; zyrtarët e lartë komunal punojnë edhe në arsim; Komuna dhe KK-ja e Prizrenit shpërfillin kërkesën e MAPL-së; Pushteti lokal i Prizrenit sfidon autoritetin e Gjykatës Kushtetuese; Rregullorja për trajtimin e ndërtimeve pa leje është kopje anti-ligjore.

Faza e dytë, tremujore e projektit në saje të këtyre të gjeturave edhe njëherë ka konfirmuar nevojën për monitorimin e përhershëm dhe intensiv të qeverisë komunale të Prizrenit. Në saje të monitorimit në periudhën raportuese janë bërë publike praktikatat e mos veprimit të institucioneve përgjegjëse lokale në sferën e urbanizmit, mos respektimi i dispozitave ligjore dhe kushtetuese nga kryetari dhe KK-ja, shpërfillja e kërkesave të institucioneve qendrore por edhe shërbimi pa integritet të lartë në postet publike. Po ashtu është reaguar ndaj çështjeve të ndjeshme që vazhdojnë të jenë preokupim dhe shqetësim i qytetarëve.

Një risi e projektit në këtë fazë ka qenë pjesëmarrja e monitoruesve të EC Ma Ndryshe në mbledhjet e kryetarit me drejtorët e komunës, të cilët kanë njoftuar mediet për vendimet e marra nga ekzekutivi komunal.

Për të adresuar të metat e përgjithshme të qeverisjes, rekomandojmë:

- Zbatimin e plotë i UA 2008/09 të MAPL-së dhe të legjislacionit në fuqi për rritjen e transparencës,
- Raportimin më të shpeshtë në media për çështjet që lidhen me përdorimin e buxhetit komunal, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës komunale, planifikimin urban, investimet, të hyrat komunale,
- Organizimin e konferencave periodike të shtypit,
- Organizimin e seancave pyetje-përgjigje me publikun e gjerë ose grupet e interesit,
- Përditësimin e ueb-faqes zyrtare të komunës me të dhëna e dokumente të sakta,

- Zbatimin e rekomandimeve të mëhershme të EC Ma Ndryshe për transparencë (si: Amendamenti i Rregullores për Transparencë, Anulimi i vendimit për takimet e mbyllura të kryetarit me drejtorët, publikimin e të gjitha akteve në formën e tyre preliminare si dhe përfundimtare në ueb-faqen e komunës, promovimin e mekanizmave të pjesëmarrjes qytetare, etj.),
- Të shfuqizohet rregullorja për trajtimin e ndërtimeve pa leje meqë bëhet fjalë për një kopje anti-ligjore,

Rekomandimet specifike (sektorale) përfshijnë:

- Mos respektimi i kriterëve të ndërtimit duhet të ndëshkohet nga institucionet përkatëse,
- Të ndalohen praktikat e investimeve publike në pronat e kontestuara,
- Zyrtarët e lartë komunal që punojnë edhe në arsim duhet së paku t'i respektojnë parimet e sjelljes morale dhe të heqin dorë nga angazhimi në dy vende të punës gjatë orarit të njëjtë dhe të përqendrohen në detyrat e tyre të rëndësishme në qeverinë komunale,
- Komuna dhe KK-ja e Prizrenit të mos e shpërfillin kërkesën e MAPL-së, por të anulojnë vendimin për kushtëzimin e regjistrimit të automjeteve me pagesën e borxhit të mbeturinave, i cili nuk ka bazë ligjore,
- Pushteti lokal i Prizrenit ta zbatoj në përpikëri aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me rastin Nr. KI 56/09,

## II. Për projektin

Ekzekutivi i komunës, i cili tashmë udhëhiqet nga kryetari i komunës (i cili i emëron dhe shkarkon drejtorët komunalë sipas vullnetit të tij personal), po promovon një cilësi të re të qeverisjes lokale dhe të ofrimit të shërbimeve publike. Ndonëse ky ndryshim nuk është gjithmonë pozitiv, ekzekutivi i komunës (sidomos kryetari) po shndërrohet në adresën e vetme të përgjegjës, dhe si pasojë të llogaridhënies, në raport me qeverisjen e mirë dhe shërbimet cilësore publike. Mbikëqyrja e punës së kryetarit (sidomos pjesa e ligjshmërisë) është ndër sfidat më të mëdha të qeverisjes lokale në Kosovë. Derisa Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal vlerësohet jo mjaftueshëm efektive, as Kuvendet Komunale dhe sistemi gjyqësor nuk po tregojnë rezultate më të mira. Dimensioni i fundit i kësaj mbikëqyrjeje, kontrolli qytetar, krahas pengesave politike, po has edhe në absurditete ligjore (Neni 72 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale për largimin e kryetarit nga detyra).

Janë evidentuar shumë raste gjatë këtyre dy mandateve të fundit, kur Kryetarë komunash kanë vepruar pa konsultim paraprak me Kuvendin Komunal dhe në shumë raste pa vendim të këtij organi. Kjo praktikë ka ngritur shqetësime të shumta në raport me respektimin e ligjit nëpër komunat e Kosovës.

Përkrahësit e sistemit mayoral janë të vetëdijshëm për formulën e dëmtimit të demokracisë në nivel lokal. Kjo formulë arrihet kur Kryetari i komunës tregohet shumë i sofistikuar në aftësitë e tij manipuluese, derisa në të njëjtën kohë Kuvendi Komunal tregohet i ngathtë në përmbushjen e obligimeve dhe ushtrimin e plotë të kompetencave (ligjore dhe mbikëqyrëse). Disa nga rastet e keqpërdorimit të pushtetit ekzekutiv janë shfaqur në komunën

e Prizrenit, derisa për njërin nga këta raste EULEX aktualisht është duke zhvilluar hetime ndaj kryetarit të komunës së Prizrenit. Edhe Prokuroria e Qarkut të Prizrenit ka autorizuar Njësinë për Krime Ekonomike dhe anti-Korrupsion të Policisë së Kosovës për të hetuar disa raste të dyshimta për korrupsion dhe shpërdorim të detyrës zyrtare nga zyrtarët e lartë komunal.

Për këtë arsye, monitorimi dhe raportimi për aktivitetet e keqqeverisjes (sidomos të ekzekutivit të komunës) do të duhej të ishte detyrë primare e shoqërisë civile në raport me qeverisjen e mirë në nivel lokal.

Transparenca online e komunës së Prizrenit është projekt për monitorimin e punës së organeve komunale. Fokusi themelor i monitorimit është ekzekutivi i komunës (kryetari i komunës dhe drejtoritë) si dhe shërbimi civil. Monitorimi bëhet përmes monitoruesve permanentë, të cilët kenë prezencë të rregullt në zyrat komunale dhe qasje të papenguar në dokumentet zyrtare të komunës. Raportimi i të gjeturave të monitorimit përdorë gjithashtu një mekanizëm permanent, ueb-faqen e transparencës së qeverisjes lokale. Të gjeturat e monitorimit postohen drejtpërdrejtë në ueb-faqen e projektit, për të krijuar mundësi qasjeje për të gjitha palët e interesuara. Të gjeturat e monitorimit janë bazë e veprimit për nivelin e dytë të aktiviteteve të projektit, avokimin dhe adresimin e shkeljeve ligjore. EC Ma Ndryshe përdorë mundësitë ligjore për të nisur procedura të adresimit të shkeljeve ligjore nga ana e komunës.

Në gjashtë muajt e parë (mars-shtator 2012) projekti Transparenca online e komunës së Prizrenit është mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Ndërsa

nga shtatori i këtij viti vazhdimi i projektit është mundësuar në saje të mbështetjes së Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.

Qëllimi themelor i projektit është forcimi i qeverisjes së mirë në komunën e Prizrenit. Objektivat specifike që do të ndihmojnë arritjen e këtij qëllimi janë: Përmirësimi i nivelit të informimit të përgjithshëm të publikut mbi vendimmarrjen lokale, Aktivizimi i mekanizmave qeveritarë dhe gjyqësorë për adresimin e praktikave që cenojnë ligjshmërinë, Rritja e nivelit të transparencës komunale në vendimmarrje, Rritja e vigjilencës së vendimmarrësve lokalë në raport me respektimin e ligjshmërisë në qeverisjen lokale, Rritja e pjesëmarrjes së grupeve të komunitetit në vendimmarrjen lokale.

### III. Pse monitorim i transparencës

Në dekadën e kaluar fokusi ndaj transparencës, si një aspekt i përmirësimit të qeverisjes dhe luftës kundër korrupsionit, ka qenë në nivel kombëtar, që lidhet kryesisht me prirjet globale të pluralizmit, demokratizimit dhe përmirësimit të qeverisjes. Në një aspekt, kjo është e kuptueshme, pasi që korrupsioni - pasojë më e spikatur e mungesës së transparencës – shpesh është më i dukshëm në nivel kombëtar, dhe për shkak se institucionet e legjislativit, ekzekutivit apo gjyqësorit kanë qenë pikë tradicionale e referencës për luftimin e korrupsionit. Kohët e fundit, megjithatë, ekziston një ndryshim në drejtim të rritjes së transparencës në nivel lokal.

Gjithnjë e më shumë po kuptohet rëndësia e ndërtimit të transparencës në nivel lokal si mjet për trajtimin e disa nga sfidave më të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm dhe demokracinë.

Janë dy aspekte themelore të qeverisjes (dhe qeverisjes së mirë). Së pari, koncepti i qeverisjes është më i gjerë se qeveria. Në kontekstin urban, kjo do të thotë se përgjegjësia për menaxhimin e çështjeve të një qytetit nuk është e kufizuar në pushtetin lokal, por përfshin një shumëllojshmëri të gjerë të palëve të interesuara, duke përfshirë: qeverinë qendrore dhe lokale, sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile dhe ato të bazuara në komunitet, mediet, shoqatat profesionale dhe anëtarë të tjerë të shoqërisë civile. Së dyti, koncepti i qeverisjes fokusohet në institucionet dhe proceset. Në kontekstin e burimeve të pakta, që konkurrojnë, por të vlefshme, prioritetet duhet të vendosen me anë të proceseve që përfshijnë të gjitha palët e interesuara në vendimmarrje. Kjo ka implikime të rëndësishme për zhvillimin e një kornize për promovimin e transparencës në nivel lokal.

Transparenca në proceset vendimmarrëse dhe në institucione ka potencial të bëhet një strategji qendrore për t'u angazhuar aktorët, luftën kundër korrupsionit dhe përmirësimin e cilësisë së qeverisjes urbane në përgjithësi. Prandaj, transparenca paraqet parimin thelbësor të qeverisjes së mirë. Qasja e lirë në informata luan një rol të rëndësishëm në promovimin e transparencës. Informacioni, megjithatë, duhet të jepet në kohë, të jetë relevant, i saktë dhe i plotë për t'u përdorur në mënyrë efektive. Çështjet se kush e prodhon atë informacion, dhe për çfarë qëllimi, bëhen aspekte kyçe të transparencës, kur interesat konkurrense konvergojnë në një çështje të veçantë.

#### IV. Ligji dhe komuna

Vetëqeverisja lokale duhet të promovoj sjelljen demokratike, transparencën dhe llogaridhënien. Ajo duhet të garantojë një sistem kontrolli të ndërsjellë në nivel komunal për ta parandaluar keqpërdorimin e pushtetit dhe zbatimin e plotë të ligjit. Pushteti lokal realizohet përmes funksionimit të ekzekutivit dhe legjislativit të saj, gjithnjë brenda kornizës ligjore të Kosovës dhe në respektim të akteve ndërkombëtare.

Kapitulli X i Kushtetutës respektivisht neni 124 paragrafi 6 përcakton se "komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore". Edhe neni 11 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale përcakton se "të gjitha aktet komunale duhet të jenë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës".

Mirëpo, hulumtimet e bëra nga monitoruesit e EC Ma Ndryshe kanë nxjerrë në pah faktin se këto dispozita janë injoruar në disa raste nga ekzekutivi dhe legjislativi i Prizrenit, gjë që ka shtyrë edhe instancat më të larta shtetërore të kërkojnë veprime konform ligjit nga autoritetet komunale.

Mungesa e dialogut të mirëfilltë me qytetarët e komunës por edhe me institucionet tjera qendrore ka shtyrë qeverinë komunale të Prizrenit të veproj jashtë kornizave ligjore, madje duke prezantuar edhe akte pa bazë juridike pranë legjislativit lokal, i cili përkundër mandatit për mbikëqyrje të ekzekutivit nuk i ka kthyer ato për rishqyrtim, por përkundrazi i ka miratuar.

Duke vepruar kështu lidërshipi komunal i Prizrenit në raste të caktuara ka injoruar Kushtetutën e Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe aktet tjera të MMPH-së dhe të

MAPL-së. Madje në rastin më të rëndë ka dështuar që të zbatoj edhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin Nr. KI 56/09. Në saje të kërkesës së EC Ma Ndryshe, ministri i MAPL-së i ka drejtuar një shkresë ligjore kryetarit të komunës dhe kryesuesit të KK-së për nevojën e zbatimit të Aktgjykimit dhe informimin e MAPL-së me hapat e ndërmarrë në këtë drejtim.

Prandaj, llogaridhënia, transparenca dhe pjesëmarrja e publikut nuk duhet të anashkalohe për hir të volisë, por duhet të jenë pjesë e procesit të vendimmarrjes që zhvillohet brenda Kuvendit të Komunës dhe ekzekutivit. Për më shumë zyrtarët e lartë komunal duhet të jenë shembull për respektimin e ligjit dhe shërbimin ndaj interesave të qytetarëve.

#### V. Aktivitetet/raportimi

Në periudhën raportuese të projektit EC Ma Ndryshe ka ndërmarrë aktivitete të monitorimit duke përfshirë edhe avokimin dhe adresimin e shkeljeve ligjore të komunës së Prizrenit tek institucionet relevante, si MAPL-ja.

Monitorimi ka qenë i përqendruar në degët e ekzekutivit të komunës (kryetari i komunës dhe drejtoritë) si dhe shërbimi civil. Monitorimi është kryer përmes monitoruesve permanentë, të cilët kanë pas prezencë të rregullt në zyrat komunale dhe qasje në dokumentet zyrtare të komunës.

Të gjeturat e monitorimit janë postuar në ueb-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org). Po ashtu janë lëshuar komunikatat e rregullta (javore ose dy-javore) për media, me informata përmbledhëse të të gjeturave të monitorimit.



Gjatë kësaj periudhe kryetari i komunës së Prizrenit ka ftuar EC Ma Ndryshe që të jetë e pranishme në mbledhjet e qeverisë komunale. Me qëllim të informimit të publikut me vendimet e marra EC Ma Ndryshe ka publikuar pesë njoftime përkatëse rreth vendimeve të qeverisë lokale të Prizrenit.

Në raste të caktuara EC Ma Ndryshe ka reaguar edhe ndaj shkeljeve procedurale dhe ligjore të ekzekutivit dhe të legjislativit, bashkë edhe me organizatat tjera që monitorojnë punën e legjislativit komunal. Po ashtu ka realizuar kontakte me institucionet e nivelit qendror me qëllim të adresimit të kërkesave për respektim të ligjit dhe të Kushtetutës së vendit.

#### **VI. Të gjeturat specifike të monitorimit**

Gjatë periudhës raportuese të projektit janë monitoruar disa dikastere të qeverisjes lokale. Më poshtë janë të gjeturat specifike në monitorimit për sferat e urbanizmit, shërbimeve publike, arsimit dhe hartimit të akteve komunale.

*Mos respektimi i kriterëve të ndërtimit nuk ndëshkohet nga institucionet* – Gjendja e krijuar në fushën e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor në Qendrën Historike të Prizrenit është alarmante pasi që ndërtimet vazhdojnë me shpërfillje të lejeve të ndërtimit të dhëna nga DUPH-ja. Këtë trend e kanë konfirmuar rastet konkrete, që janë hulumtuar nga monitoruesit e EC Ma Ndryshe. Kompleksi afarist-banesor “Euro-Center” është ndërtuar në Zonën e Mbrojtur të Qendrës Historike të Prizrenit. DUPH dhe Inspektorati (ekzekutivi komunal) është treguar tolerant ndaj këtij investitori duke i mundësuar ndërtim më etazhitet më të lartë, pa leje përkatëse. Pos

ndërtimit tanimë të përfunduar të këtij objekti, ky investitor, nuk është ndalur më kaq duke filluar edhe aneksin tjetër po ashtu pranë këtij objekti pa kurrfarë kriteri. Mirëpo ky nuk është rasti i vetëm që investitorët nuk respektojnë lejen ndërtimore. Një objekt i tillë është në ndërtim e sipër dhe përgjegjësit duhet të ndërmarrin veprime parandaluese në afat sa më të shkurtër kohor, ngase në të kundërtën do të jetë vonë, si në rastin e “Euro-Center”. Konkretisht për tejkalimet në ndërtimin e vrazhdë pranë shtëpisë së Shuaip Spahisë më 5 shtator të këtij viti IMMK-ja ka alarmuar Drejtorinë e Inspektorateve të komunës së Prizrenit. Sipas aktvendimit të Drejtorisë së Inspektorateve të datës 7 shtator 2012, investitori nuk i është përmbajtur lejes urbanistike “dhe ka bërë tejkalim në gabarit dhe etazhitet të objektit”. Me këtë aktvendim DI-ja ka urdhëruar investuesin e punimeve që në afatin prej 7 ditësh të bëj rrënimin e pjesës shtesë në gabarit dhe etazhitet. Për këtë rast kanë reaguar edhe institucionet tjera si, Këshilli i Bashkësisë Islame në Prizren, ndërsa më 12 shtator 2012 DI-ja ka parashtruar një kërkesë pranë Gjykatës për Kundërvajtje për fillimin e procedurës kundërvajtës, me arsyetimin se investuesi nuk e ka respektuar lejen e ndërtimit të lëshuar nga DUPH-ja.

*Praktika e investimeve publike në pronat e kontestuara* – Gjatë hulumtimeve të bëra EC Ma Ndryshe ka hasur në një rast, i cili është shqetësues për arsye se paratë publike janë investuar në një hapësirë, e cila ka qenë subjekt i kontestit pronësor, në shqyrtim në Gjykatën Supreme të Kosovës. Projekti - Krijimi i Kushteve për Zhvillim të Turizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, nëpërmes ndërtimit të vend Piknikut në komunën Prizren – ku palë nënshkruese kanë qenë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe komuna e



Prizrenit, ka nisur së zbatuari në vendin e quajtur “Brione”, pavarësisht nga fakti se Gjykata komunale dhe ajo e Qarkut të Prizrenit kanë vlerësuar se prona ku kanë nisur punimet i takon familjeve Dehiri-Hapçiu. Ndërkohë rasti ka qenë në revidim në Gjykatën Supreme. Më 1 gusht 2012 Gjykata Komunale me aktvendim pat caktuar masën e përkohshme për ndalimin e punimeve. Një gjë e tillë nuk është respektuar nga komuna e Prizrenit dhe punimet kanë vazhduar.

#### *Zyrtarët e lartë komunal punojnë edhe në arsim*

– Një hulumtim tjetër në sektorin e arsimit respektivisht sistemimin e zyrtarëve të lartë të ekzekutivit lokal nëpër shkollat fillore dhe të mesme të komunës së Prizrenit ka treguar se së paku tre këshilltarë të kryetarit të komunës, Ramadan Muja dhe një zyrtare e lartë e DKA-së marrin paga për vendet e tyre të punës në ekzekutivin lokal dhe në të njëjtën kohë janë pjesë e listës së pagave të shërbimit arsimor. Ndonëse këta zyrtar të lartë kanë normë të përgjysmuar në shkollat fillore dhe të mesme, megjithatë ata marrin paga dy herë për punën që e bëjnë gjatë orarit të njëjtë të punës. Bazuar në deklaratat e kryetarit të komunës pothuaj të gjitha shkollat e komunës së Prizrenit zhvillojnë mësimin në dy turne, që do të thotë se mësimi në shkolla zgjat gati aq sa edhe orari i punës në komunë, ndoshta me një dallim shumë të ngushtë kohor, gjë që e bën të pamundur praninë fizike në dy vende të punës në kohën e njëjtë. Edhe nëse dispozitat ligjore e lejojnë një praktikë të tillë, megjithatë zyrtarët e lartë komunal, që madje janë bashkëpunëtorë të ngushtë të kryetarit, duhet së paku t'i respektojnë parimet e sjelljes morale dhe të heqin dorë nga angazhimi në dy vende të punës gjatë orarit të njëjtë dhe të përqendrohen në detyrat e tyre të rëndësishme në qeverinë komunale.

*Komuna dhe KK-ja e Prizrenit shpërfillin kërkesën e MAPL-së – EC Ma Ndryshe ka siguruar shkresën shpjeguese të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) drejtuar komunave të Kosovës, përmes të cilës sqarohet se kushtëzimi i shërbimeve të komunës ndaj qytetarëve me pagesën e borxheve ndaj Ndërmarrjeve Publike Rajonale e Lokale, nuk kanë bazë ligjore dhe se si të tilla nuk mund të aplikohen. Zv. Kryeministri dhe ministri i MAPL-së, Slobodan Petroviq u ka shkruar kryetarëve të komunave dhe kryesuesve të KK-ve lidhur me kushtëzimin e shërbimeve publike komunale, respektivisht kushtëzimin e regjistrimit të automjeteve me pagesën e faturave të mbeturinave dhe ka konstatuar se kjo është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës. Në këtë shkresë MAPL ka theksuar se kushtëzimet mund të aplikohen duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 3/2004, që parasheh pagesën e tatimit në pronë me qëllim të pajisjes me dokumente kadastrale, ndërtimore, lejeve të caktuara dhe pronësinë e automjeteve. Në bazë të kësaj MAPL ka kërkuar nga kryetarët dhe kryesuesit që vendimet e tyre t'i nxjerrin në harmoni me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës. Ndonëse sqarimi i MAPL-së është bërë katër muaj më parë, kryetari i komunës së Prizrenit dhe kryesuesi i KK-së nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për anulimin e vendimit të KK-së së Prizrenit për kushtëzimin e dhënies së dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e automjeteve me pagesën e shërbimeve të mbeturinave.*

*Pushteti lokal i Prizrenit sfidon autoritetin e Gjykatës Kushtetuese – Monitoruesit e EC Ma Ndryshe kanë konstatuar se Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin Nr. KI 56/09 nuk është zbatuar në tërësi, si nga komuna e Prizrenit e po ashtu edhe organet përkatëse të gjyqësorit. Si rrjedhojë qytetarët e lagjes*

“Dardania” edhe pse kanë dal fitues nga një betejë e gjatë ligjore, që ka përfunduar me vendimin e instancës më të lartë për interpretimin e Kushtetutës së Kosovës, ende nuk kanë arritur që të realizojnë të drejtën e tyre, respektivisht të gëzojnë zonën e gjelbër në lagjen e tyre. Në këtë lokalitet vazhdon të qëndroj i paprekur objekti që ishte në ndërtim e sipër nga komuna e Prizrenit, edhe pse në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese theksohet se kjo është në kundërshti me nenin 52.2 të Kushtetutës dhe kërkohet nga KK-ja që brenda gjashtë muajve nga data e shpalljes së aktgjykimit, t’i dorëzohen Kushtetueses informata për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij aktgjykimi. Ndonëse kanë kaluar afër dy vjet nga shpallja e Aktgjykimit të Kushtetueses organet komunale nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim për zbatimin e tij. As institucionet tjera, duke përfshirë edhe gjyqësorin dhe vet Kushtetuesen nuk janë përkujdesur që ky aktgjykim të zbatohet në tërësi, brenda afatit të përshkruar në vet Aktgjykimin e GJK-së. EC Ma Ndryshe konsideron se në këtë mënyrë institucionet publike, të të gjitha pushteteve, kanë injoruar të drejtën e qytetarëve të lagjes “Dardania”, të cilët kanë ndjekur të gjitha procedurat dhe në mënyrë institucionale kanë vërtetuar të drejtën e tyre për mbrojtjen e ambientit jetësor.

*Rregullorja për trajtimin e ndërtimeve pa leje – kopje anti-ligjore* – Pas hulumtimit në hollësi të sfondit ligjor dhe praktikave të aplikuara nga komunat tjera, është konstatuar se komuna e Prizrenit nuk ka bazë të duhur ligjore për miratimin dhe zbatimin e rregullores për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Komisioni MMPH-MAPL për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave nga fusha e ndërtimit ka vlerësuar se “kjo rregullore duhet të jetë rrjedhshmëri nga Ligji për trajtimin e objekteve

pa leje apo të ndonjë akti nënligjor, i cili do të nxirrej nga institucionet e qeverisjes qendrore-dokumente këto të cilat nuk janë nxjerrë në shqyrtim. Dihet ligjërisht, që aktet nënligjore ose Rregulloret nxirren në bazë dhe në zbatim të një ligji çfarë nënkupton se ato janë një lloj zgjatimi i ligjit dhe mundet kurrsesi të bien ndesh apo të tejkalojnë urdhërimet e ligjit mbi të cilin bazohen”. Gjatë hulumtimit EC Ma Ndryshe po ashtu ka gjetur se Rregullorja për trajtimin e ndërtimeve pa leje e KK-së së Podujevës e miratuar më 29 prill 2011 është pothuajse identike me atë të miratuar nga KK-ja e Prizrenit, më 18 tetor 2012.

## VII. Rekomandime

Në bazë të të gjeturave të deritanishme në sektorët specifik të qeverisjes lokale, EC Ma Ndryshe ka rekomanduar ndërmarrjen e një numri veprimesh për të përmirësuar nivelin e transparencës, performansën e qeverisjes, menaxhimin financiar në këta sektorë: urbanizëm, inspektorat, arsim, shërbime publike, etj. Për shkak të përgjegjësisë së përbashkët në shumë raste, rekomandimet u drejtohen organeve komunale, institucioneve qendrore dhe institucioneve të rendit dhe drejtësisë.

*Mos respektimi i kriterëve të ndërtimit duhet të ndëshkohet nga institucionet përkatëse* – Qeveria lokale e Prizrenit urgjentisht duhet të ndërmarrë veprime të nevojshme në drejtim të normalizimit të gjendjes në Qendrën Historike të Prizrenit dhe të zbatoj në përpikëri Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit (2008). Ekzekutivi komunal duhet të ndërmarrë veprime parandaluese, ndërsa në rast të vazhdimit të punimeve, edhe veprime ndëshkuese ndaj personave që nuk i

respektojnë kriteret e ndërtimit. Madje, siç përshkruhet edhe në njërin prej procesverbaleve të DI-së, meqë investuesit nuk e kryejnë rrënimin vullnetar, atëherë ky organ duhet të bëjë rrënimin e dhunshëm të etazheve shtesë me kosto që do t'i përshkruhej investuesve të papërgjegjshëm. Në të njëjtën kohë EC Ma Ndryshe kërkon veprim më të fuqishëm ndër-institucional dhe i bën thirrje gjyqësorit që t'i merr parasysh shkresat e ekspertëve të komunës së Prizrenit dhe të inicioj procedurat gjyqësore ndaj atyre që shkelin dispozitat e Rregullores për Ndërtimin e Objekteve.

*Të ndalohen praktikat e investimeve publike në pronat e kontestuara* – Qeveria lokale e Prizrenit ashtu edhe Qeveria e Kosovës – MAPL duhet të respektojë vendimet e gjyqësorit, me qëllim të ndërtimit të shtetit ligjor. Para fillimit të ndërtimit të vend piknikut komuna e Prizrenit është dashur që të arrij marrëveshje me familjet Dehiri-Hapçiu, në mënyrë që të mos rrezikohet dhe humbet investimi i parave publike. Qeveria lokale duhet që të shter të gjitha mundësitë ligjore para se të orienton paratë publike në një hapësirë që ka kontest pronësor. Ky rast duhet të shërbej si shembull për mos përsëritjen e praktikave të tilla në të ardhmen.

*Zyrtarët e lartë komunal që punojnë edhe në arsim* – Zyrtarët komunal duhet së paku t'i respektojë parimet e sjelljes morale dhe të heqin dorë nga angazhimi në dy vende të punës gjatë orarit të njëjtë të punës dhe të përqendrohen në detyrat e tyre të rëndësishme në qeverinë komunale. DKA, udhëheqja komunale dhe MASHT-i duhet të rishikojnë sistemimin e mësimdhënësve në komunën e Prizrenit. MASHT-i rekomandohet që të ndryshoj edhe dispozitat përkatëse ligjore në mënyrë që të pamundësohet angazhimi i

zyrtarëve të lartë komunal në shërbimet arsimore komunale. Ndërsa nga autoritetet komunale kërkohet aplikimi i standardeve të larta morale në mënyrë që të krijohet hapësira e duhur për punësimin e kuadrove të reja, në kushte të barabarta dhe pa ndikime partiake e politike, me qëllim të avancimit të cilësisë së shërbimeve arsimore.

*Kryetari dhe KK-ja e Prizrenit të mos e shpërfillin kërkesën e MAPL-së* – Kryetari dhe kryesuesi duhet të anulojnë vendimin për kushtëzimin e regjistrimit të automjeteve me pagesën e borxhit të mbeturinave, i cili nuk ka bazë ligjore. Sqarimet e MAPL-së në këtë drejtim janë të qarta dhe se ato duhet të zbatohen pa asnjë vonesë, me qëllim të mos cenimit të drejtave të qytetarëve të komunës së Prizrenit. Pushteti lokal i Prizrenit duhet t'i bindet këshillave ligjore të MAPL-së.

*Pushteti lokal i Prizrenit të zbatoj në përpikëri aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me rastin Nr. KI 56/09* – Neglizhenca e Kryetarit dhe KK-së së Prizrenit kundruall qytetarëve të vet në radhë të parë dhe më pas edhe karshi vendimit të GJK-së është i pajustificueshëm dhe nuk shkon në dobi të qeverisjes së mirë dhe efektive lokale. Vendimet e GJK-së janë përfundimtare, të pakontestuara dhe zbatimi i tyre është i detyrueshëm, edhe për komunën e Prizrenit. Ligji për Vetëqeverisje Lokale përmban dispozita të qarta për veprime ndaj zyrtarëve dhe organeve komunale në rast se ato dështojnë në kryerjen e funksionit sipas standardeve të përcaktuara me ligj dhe për shkelje të Kushtetutës. EC Ma Ndryshe rekomandon edhe Gjykatën Kushtetuese që në të ardhmen të jetë më aktive sa i përket përcjelljes së zbatimit të vendimeve të saj dhe të mos vonohet sikurse në rastin "Dardania". Po ashtu përkujton të gjitha institucionet publike se ato janë shërbim për

përmbushjen e detyrave karshi qytetarëve dhe jo për shkeljen e të drejtave të tyre.

*Të shfuqizohet Rregullorja për trajtimin e ndërtimeve pa leje meqë bëhet fjalë për një kopje anti-ligjore* – Rekomandohet kryetari i komunës së Prizrenit që të jetë më i kujdesshëm dhe më i përgjegjshëm gjatë propozimit të Rregulloreve që kanë ndikim të madh në jetën e qytetarëve, urbanizmin dhe të ardhmen e komunës; Po ashtu praktika e kopjimit të Rregulloreve apo vendimeve të komunave tjera, duhet të ndërpritet, në mënyrë që secili akt apo dokument që propozohet nga kryetari apo organet tjera komunale të Prizrenit të jenë në përputhje me nevojat, kërkesat dhe interesat e qytetarëve të komunës së Prizrenit; Gjithashtu anëtarët dhe kryesuesi i Kuvendit Komunal rekomandohen që të jenë në nivel të detyrës, të kryejnë funksionin e kontrolluesit të ekzekutivit dhe të jenë më rigoroz në respektim të ligjit, duke refuzuar miratimin e akteve që nuk kanë bazë ligjore.

### VIII. Ndikimi i Projektit

Ndikimi i fazës së dytë të projektit është vërejtur në mbulesën mediale të ofruar për të gjeturat dhe aktivitetet e projektit, interesimin e qytetarëve për të raportuar raste të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, vazhdimin e veprimeve dhe hetimeve në urbanizëm, insistimin e MAPL-së për zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, interesimin e organizatave ndërkombëtare për monitorimin e ekzekutivit, bashkëpunimin e OJQ-ve dhe numrin e vizitave (klikimeve) në ueb-faqen e projektit.

Mbulesa mediale – Të gjeturat dhe aktivitetet e projektit janë raportuar gjerësisht nga të gjitha

mediat e Kosovës, përfshi televizionet lokale, televizionet qendrore (ndonëse më rrallë), gazetat ditore dhe portalet e internetit. Komunikatat e rregullta dhe konferencat për media janë mbuluar rregullisht nga televizionet lokale të Prizrenit, kryesisht në kuadër të edicioneve qendrore të lajmeve. Për më tepër, të gjeturat dhe raportet e monitorimit kanë shërbyer për përgatitjen e kronikave të shumta televizive në kuadër të emisione të ndryshme, ndërsa stafi i projektit dhe i organizatës është ftuar në disa emisione për të diskutuar rreth monitorimit dhe transparencës në komunën e Prizrenit. Gjatë periudhës shtator – nëntor 2012, raportimet e monitorimit janë pasqyruar përmes afro 30 kronikave televizive (rreth një orë mbulesë) dhe 30 artikujve gazetaresk (rreth 15 faqe gazete).

Raportimi qytetar – Në periudhën raportuese ka vazhduar vullneti i qytetarëve të Prizrenit për të raportuar në projekt raste të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe shqetësime të tjera. Një rast i tillë është duke u trajtuar aktualisht nga monitoruesit dhe ekipi i projektit. Në fazën e dytë të projektit EC Ma Ndryshe i ka inkurajuar qytetarët e Prizrenit që të bëhen pjesë e projektit për monitorimin e qeverisjes lokale, duke i raportuar rastet e qeverisjes së keqe, keqmenaxhimit, mungesës së transparencës, korrupsionit, mashtrimit, konfliktit të interesit apo formave të tjera të keqpërdorimit të pozitës nga zyrtarët apo nëpunësit civilë të komunës së Prizrenit.

Ndërmarrja e veprimeve dhe vazhdimi i hetimeve në urbanizëm – Prokuroria e Qarkut në Prizren gjatë periudhës raportuese ka zgjeruar hetimet për shkeljet në urbanizëm, në zonat e ndryshme të komunës. Ndërkohë Inspektorati dhe DUPH-ja kanë vendosur shirita për ndalimin e punimeve në ndërtesat kolektive

që janë në ndërtim e sipër pa leje apo me tejkalime urbanistike. Operatorët nuk i kanë përfillur urdhrat zyrtar dhe kanë vazhduar punimet, ndërkohë që autoritetet komunale kanë kërkuar veprim nga organet e drejtësisë.

MAPL letër komunës pas raportimit të EC-it – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal i ka dërguar një shkresë ligjore Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit në lidhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese për rastin e ndërtesave kolektive në lagjen Dardania. Pas reagimit të EC Ma Ndryshe në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe kërkesës drejtuar MAPL-së për të ndërmarrë veprime ndaj zyrtarëve të komunës së Prizrenit, Ministri i MAPL-së Z. Slobodan Petrovic në letrën e tij dërguar Z. Muja dhe Z. Kryeziu, ndër të tjerash kërkon të informohet "për hapat e ndërmarrë për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese".

Interesimi i organizatave ndërkombëtare për monitorimin e ekzekutivit – Gjatë këtij tre mujori organizata të ndryshme ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë kanë shprehur interesim për t'u njohur nga afër me projektin Transparenca online e komunës së Prizrenit. Zyrtarët e misionit të OSBE-së në Kosovë gjatë një tryeze me shoqërinë civile e kanë cilësuar si të veçantë projektin, derisa ata të UNDP-së theksojnë se kjo praktikë duhet të zgjerohet edhe me përfshirjen më të madhe të rinisë.

Bashkëpunimi i OJQ-ve monitoruese – EC Ma Ndryshe si monitoruese e ekzekutivit në bashkëpunim me Institutin Demokratik të Kosovës (KDI) që monitoron legjislativin, nga afër kanë përcjellë procesin e hartimit dhe të miratimit të rregullores për trajtimin e ndërtimeve pa leje nga Kuvendi Komunal i

Prizrenit. Konstatimi i përbashkët i këtyre dy organizatave ka qenë se procesi ka pasur defekte serioze, ngase pikësëpari nuk janë respektuar udhëzimi administrativ i MAPL-së (2008/09) dhe vet statuti i komunës së Prizrenit, për organizimin e diskutimit publik në lidhje me përmbajtjen e rregullores së lartpërmendur. Monitoruesit e KDI-së dhe të EC Ma Ndryshe përmes një reagimi të përbashkët kanë shprehur shqetësimin me praktikën e ekzekutivit dhe legjislativit të Prizrenit që një rregullore kaq e ndjeshme dhe e rëndësishme për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të kaloj pa u vënë në sprovën e publikut, respektivisht pa u testuar nëse është në interesin e qytetarëve apo jo, përmes debatit të mirëfilltë publik.

Numri i vizitave (klikimeve) në ueb faqen e projektit – Numri i vizitorëve të ueb faqes së projektit ka shënuar rritje konstante. Nga disa dhjetëra vizita në javë, muajin e fundit numri i vizitorëve ka qenë mbi 1000, që nënkupton disa qindra klikime në javë. Paralelisht me ueb-faqen, EC Ma Ndryshe e shfrytëzon edhe ueb-faqen e saj zyrtare dhe faqen e saj zyrtare në Facebook për të publikuar të gjeturat dhe komunikatat e monitorimit. Faqja zyrtare e organizatës në Facebook ka një trafik prej 2000 – 3000 vizitorësh në javë.

## IX. Falënderim

I jemi mirënjohës Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë për mbështetjen financiare të këtij projekti duke filluar nga muaji shtator 2012. Ne, po ashtu i falënderohemi komunës së Prizrenit dhe në veçanti kryetarit të komunës Z. Ramadan Muja për bashkëpunimin e treguar në ofrimin e qasjes në dokumente dhe informacion zyrtar.

## EC Ma Ndryshe

Organizata jo-qeveritare “Emancipimi Civil Ma Ndryshe” u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor.

EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale në Prizrenit për të krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike. Për të ofruar një model konkret të konsultimit publik, EC Ma Ndryshe ka realizuar projektin “Forumet e Hapura Qytetare”, ku instrumenti i forumit është promovuar si model funksional i pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje. Për më tepër, përmes Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, EC Ma Ndryshe ka ngritur një platformë avokuese për komunitetin kulturor të qytetit duke e shndërruar Forumin në një pjesëmarrës aktiv të formulimit të politikave kulturore në nivel lokal.

Në emër të promovimit të mekanizmave të demokracisë së drejtpërdrejtë, EC Ma Ndryshe ka qenë pjesë e dy Peticioneve në qytetin e Prizrenit, njëri për të parandaluar rrënimin e objektit të kinemasë së qytetit dhe tjetri për të kundërshtuar projekt-ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit. Njëra ndër veprimet konkrete me të rinjtë e qytetit ka qenë bashkëpunimi me Festivalin Dokufest për të shfaqur filma dokumentarë nxënësve të shkollave të mesme të qytetit. Temat e dokumentarëve kanë përfshirë një spektër të gjerë të edukimit qytetar me qëllim përgatitjen e gjeneratave të ardhshme që do të jenë qytetarisht të përgjegjshme dhe aktive. Aktivizmi është edhe një ndër parimet udhëheqëse të veprimit të brendshëm të organizatës. Përmes Grupit të Vullnetarëve Aktiv (grup që funksionon brenda EC Ma Ndryshes) organizata ka promovuar aktivitetin vullnetar në shumë fusha, e posaçërisht në kulturë dhe trashëgimi kulturore.

*Projektet kryesore:* Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit (2012), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006. Publikimet: Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008), Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012).